| 34 | Prizreni | Njësia 74: GJI033 NSH Zadruga ShtrpceTokë Bujqësore në ZK Brod Shtërpce | Rustemi Kamadan | Tokë Bujqësore | Qiradhënie vjetore | Ofrohen për qiradhënie 3 ngastra në ZK Brod, Shterpce me numër të ngastrave kadastrale: P-72717009-01145-0 me sipërfaqe prej 82778 m² P-72717009-01146-0 me sipërfaqe prej 3037 m² P-72717009-01147-0 me sipërfaqe prej 2526 m² Informatë: Parcela nr. 1145-0 gjendet pjesërisht në PK Sharri ne siperfaqe përafërt prej 9372 m2 Siperfaqja e pergjithshme e njësisë 88341 m² | DE 55-2024 | 0 | | 88,341 m² | | € 1.66 | | € 0.92 | € 811 | 1 | Aprovim | JO | | Meqenëse në komunën e Shtërpces nuk ka ndonjë tokë bujqore të dhënë me qira atëherë për krahasim është marrur mesatarja e çmimit të kontratave në Komunë e Prizrenit. Sidoqoftë, duke i marrë parasysh kushtet e pronës, si dhe NSh-ja do të krijoj të | 88341 |
| 35 | Prishtinë | NSH Kinema ABC Genci | ARTimage shp.k | Objekt | Qiradhënie mujore | Rr."Rexhep Luci", p.n. Prishtinë | DE-62a-2024 | | | 346 | 8.17 | | € 10.69 | | € 3,700 | 2 | Aprovim | JO | € 530 | Meqenëse nuk kemi ndonjë kontratë qiraje për Kinema, për krahasim | |
| 36 | Prishtinë | Ratar- njësia 4 NSh NSH Ratar, P-73414019-02188-1- sipërfaqja 2731 m², P-73414019-02188-2 | Sasa Zdravkovic | P-73414019-02188-1 P-73414019-02188-2 | Qiradhënie Vjetore | Zona kadastrale Graçanicë | DE70a-2024 | 4 | | 5361 | | 12.59 € | | € 1.58 | € 85 | 1 | Refuzim | JO | 0 | Për shkak të çmimit të ultë të ofertës për ari, dhe krahasimit me kontratat aktuale të qirasë në lokacione të afërta, rekomandohet refuzimi i ofertes. | |
| 37 | Prishtinë | Ratar- njësia 5 NSH Ratar, P-73414042-01603 - 0, Zonë kadastrale Llapllaselle | Sasa Zdravkovic | P-73414042-01603 -0 | Qiradhënie Vjetore | Zona kadastrale Llapllaselle | DE70a-2024 | 4 | | 2460 | | 12.59 € | | € 2.03 | € 50 | 1 | Refuzim | JO | € 0.00 | Për shkak të çmimit të ultë të ofertës për | |
| 38 | Prishtinë | Ratar- njësia 6 NSH Ratar, P-71914059- 10294-1, Zonë kadastrale Prishtinë | Xhylizade Gashi | 71914059- 10294 | Qiradhënie mujore | Zonë kadastrale Prishtinë | DE70a-2025 | 1 | | 1638 | | 17.95 € | | € 27.47 | € 450 | 2 | Aprovim | JO | € 0 | | |
| 39 | Prishtinë | Ratar- njësia 7 NSH Ratar, P-73414042-202-21, Zonë kadastrale Llapllaselle | Durim Nikçi | -73414042-202-2 | Qiradhënie mujore | Zona kadastrale Llapllaselle | DE70a-2026 | 1 | | 4775 | | 17.95 € | | € 13.19 | € 630 | 3 | Refuzim | JO | 0 | Për shkak të çmimit të ultë të ofertës për | |
| 40 | Prishtinë | Ratar- njësia 8 NSH Ratar, P-73414042-1700-1 sipërfaqja 3794 m², P-73414042-1700-2 | Xhylizade Gashi | P-73414042-1700-1 sipërfaqja 3794 m2 P-73414042-1700-2 sipërfaqja 3694 m2 | Qiradhënie mujore | Zonë kadastrale Prishtinë | DE70a-2027 | 1 | | 7488 | | 17.95 € | | € 31.38 | € 2,350 | 7 | Aprovim | JO | € 0 | | |
| 41 | Prishtinë | Zyra Kati I 2-të | Kushtrim Bajrallu | Zyre | Qiradhënie mujore | Rr.Deshmoret e Kombit, Ferizaj | DE 64a-2024 | 10 | 150 | 266 | 14.01 | | € 1.40 | | € 372 | 1 | Refuzim | JO | | Për shkak të çmimit të ultë të ofertës për | |
| 42 | Prishtinë | PRN173 NewCo Grand Hotel-njësia 11 | Skender Asllani | Zyra nr.301 | Qiradhënie mujore | Sheshi Zahir Pajaziti – Prishtinë | DE 66a-2024 | 1 | € 180.00 | 18.1 | 9.09 € | - | € 11.60 | | € 210 | 2 | Aprovim | JO | | | |

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## Lista e Aseteve për qiradhënie të aseteve të NSH-ve në likuidim përmes shpalljes publike e dates 28 shkurt 2024

| Nr | Rajoni | Emri i NSH së-njësia | Emri i Ofertuesit me ofertën më të lartë | Lloji i asetit | Qiradhenie Mujore/Vjetore | Vendndodhja e Asetit dhe Komuna | Nr i vendimit të DM mbi themelimin e Komisionit për qira | Sa herë është dhënë me qira? | Cmimi më i lartë i qiradhënies paraprake ose Tenderimit te fundit | Sipërfaqja m² | Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve në Raportet e Vlerësimi per m2 | Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve në Raportet e Vlerësimi per ari | Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar m2 | Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar ari | Cmimi i Ofertës më të lartë | Numri i Ofertave | Vendim i Bordit | A ka të angazhuar momentalisht sigurim për asetin PO/JO | Shuma mujore e pegeses se Sigurimit te asetit | Koment / Verejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 43 | Prishtinë | Fabrika e Letres dhe Kartuçit Lipjan, P-72217092-00492-2 | | Toke Komerciale | Qiradhënie mujore | Ferizaj | DE 63a-2024 | 0 | N/A | 500 | | | | €0.71 | €356 | 4 | Anulim | JO | | Oferta më e lartë në vlerë prej 500.00€, rezultoj të jetë një ofert e "Proxy |
| 44 | Prishtinë | NSh Auto Moto e Kosovës | Butires and Strategy Consulting sh.p.k | Pjesa e shfrytëzueshme pa ndërtime e trotuare e sipërfaqes tokësore të n.k.7587-2 | Qiradhënie mujore | Lagje Emshir (te banesat e arabëve), Prishtinë | De 61 a 2024 | | | 12200 | 0.23 € | | € 1.22 | | €14,838 | 6 | Aprovim | JO | | |
| 45 | Prishtinë | NSh Auto Moto e Kosovës | Yll Rrecaj | Pjesa e shfrytëzueshme pa ndërtime e trotuare e sipërfaqes tokësore të n.k.Pjesa e shfrytëzueshme pa ndërtime etj sipërfaqes tokësore të n.k.7585-2 | Qirathënie mujore | Lagje Emshir (te banesat e arabëve), Prishtinë | De 61 a 2024 | | N/A | 2000 | 0.23 € | | € 4.00 | | €8,000 | 7 | Aprovim | JO | | |
| 46 | Prishtinë | KB KOSOVA | Valon Vataj | Tokë bujqësore | Qiradhënie mujore | Gushtericë e Ulët | DM 65a/2024 | 0 | | 3800 | | 18.22 | | €14.08 | €535 | 2 | Refuzim | JO | | Për shkak të çmimit të ulët të ofertës për ... |



MH

Nr. Ref. BD-200/22

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullore Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Udhëzuesi për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 mars 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohen qiradhënia e lolakit afarist nr.11 në Rahovec, pronë e NSh Jatex-Gjakovë sipas listës së bashkëngjitur.**

**II. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin nga Menaxhmenti për shqyrtimin e rezultateve/çmimeve të ofertimit nga qiradhënia e asetit të NSh Jatex përmes shpalljes publike sipas rezultateve të datës 15.02.2024.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore pa marrë parasysh a janë vendosur ndërmarrjet në likuidim apo jo me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së.
Prandaj, dhënia eventuale me qira e aseteve në shtojcë do ti shërbente rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për të paguar shpenzimet e likuidimit, pagesat për kreditorëve dhe transferohen eventualisht në Buxhetin e Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë/indirekt i të hyrave nga inkasimi i qirave.
Kontratat e qirasë për asetet e ndërmarrjeve në likuidim nënshkruhen nga Kryesuesit e Autoriteteve të Likuidimit sipas autorizimeve të parapara në Shtojcën e ligjit të AKP-së.
Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 mars 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Lista e asetit për qiradhënie të NSH Jatex përmes shpalljes publike të datës 15 shkurt 2024 (Ofertat e pranuara ).**

| Nr | Rajoni | Emri i NSH-së-njësia | Emri i Ofertuesit me ofertën më të lartë | Lloji i asetit | Qiradhenie Mujore/Vjetore | Vendndodhja e Asetit dhe Komuna | Nr i vendimit të DM mbi themelimin e Komisionit për qira | Sa herë është dhënë me qira? | Cmimi më i lartë i qiradhënies paraprake ose Tenderimit te fundit | Sipërfaqja m² | Cmimi krahasues për m2 në bazë të krahasimeve në Raportet e Vlerësimi | Cmimi për m2 i ofertës më të lartë të pranuar | Cmimi i Ofertës më të lartë | Numri i Ofertave | Rekomandim nga Komisioni | Aprovuar/ Refuzuar nga Menaxhmenti | A ka të angazhuar momenalisht sigurim për asetin PO/JO | Shuma mujore e pageses se Sigurimit te asetit | Koment / Verejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Peje | Jatex | Genc Vezvesja | lokal afarist | mujore | Rahovec | DE 87-2024 | 1 | 100 | 65.5m2 | 1.77 | € 1.85 | € 121.00 | 2 | PO | PO | JO | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-200/23

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores nr, 7/2023 për qiradhënie të aseteve të NSh-ve, Nenit 2.5 të Kontratës së Qirasë me nr. protokolli 3264-2016 në mes të PEJ0056 NSh KB Kooperimi - Pejë dhe Ukë Shala dhe Nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 mars 2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

I. **Aprovohet kërkesa e Qaush Shala për transferimin e Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e parcelës nr. 388/2 ZK Treboviq me sipërfaqe prej 2ari 65m² nga Ukë Shala tek Lindor Shala me qira vjetore prej 6.00 €/vit për asetin e PEJ0056 NSh KB Kooperimi - Pejë**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

**ARSYETIM**

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratës së qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se Ukë Shala ishte qiramarrës i tokës bujqësore sipas kontratës me NSh KB Kooperimi, konkretisht parcelën 388/2 prej 2ari 65m² ZK Treboviq, Komuna Pejë fleta poseduese nr.01-45-15, me nr. të kontratës 3264-2016 të dt. 12.12.2016. Familjarët e tij ende janë duke e shfrytëzuar të njëjtën tokë bujqësore sipas Aneks Kontratës nr. 323/2023 te dt.28.02.2023 për periudhën kohore 01.12.2022 - 30.11.2023. Të njëjtit pasi që janë kontaktuar për vazhdim të kontratës pas 30.11.2023 na kanë informuar që qiramarrësi ka ndërruar jetë dhe se janë të gatshëm të vazhdojnë kontratën e qirasë dhe se do të paraqesin kërkesën dhe të gjithë dokumentet e nevojshme për transferim të kontratës së qirasë. Pasi që z. Ukë Shala ka ndërruar jetë më datë 24.11.2023. Z. Qaush Shala, djali i të nderit z. Ukë Shala ka kërkuar përmes shkresës të pranuar me dt.04.03.2024, që të bartet kontrata në emër të djalit i tij z. Lindor Shala, për arsye të ndarjes së trashëgimisë private në mes familjarëve ku pjesa e parcelës qe shfrytëzohet është fqinjë me parcelën e djalit Lindor Shala.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke marrë gjithashtu për baze se qiramarrësi aktualisht është i rregullt me pagesa, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrëtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 mars 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-200/24

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 te Ligjit te AKP-në, Nenit 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSH, Nenit 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 mars 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të dy hapësirave të Asetit NSh Borba në Prishtinë PRN206 dhe ndryshohet vendimi i Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-198/36 të datës 28.02.2024 ashtu që për lokalin nr.1 për parashtruesin D.P.Z "Studio Meli &Nifa" për shkak të ndryshimit të sipërfaqes së përgjithshme sipas raportit të vlerësimit ndryshohet edhe çmimi i qirasë sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 218.00 € për një muaj.**

**II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive, duke e llogaritur nga Qershor 2023, ku me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së me Nr. Ref.BD-183/26 të datës 23 qershor 2023 ky aset është vënë nën administrimin e AKP-së. Për shfrytëzimin e lokalit nr.1 qiramarrësit D.P.Z "Studio Meli&Nifa" në sipërfaqe prej 50 m2 në shumën prej 218.00 €/muaj do të i kërkohet të paguajë retroaktivisht shumën prej 1,962.00 € (qershor 2023 – shkurt 2024), ndërsa për shfrytëzimin e lokalit nr. 3 qiramarrëses Florie Vllasaliu B.I. do i kërkohet të paguajë retroaktivisht shumën prej 2,070.00 € para nënshkrimit të kontratës së qirasë.**

**III. Në qoftë se qiramarrësit nuk mund të paguajnë shumat për periudhat retroaktive para nënshkrimit të kontratës së qirasë, atëherë i lejohet riprogramimi i këtij borxhi, për një periudhë jo më tepër se gjashtë (6) muaj brenda periudhës së vlefshmërisë së kontratës së qirasë.**

**IV. Obligohet Autoriteti i Likuidimit që të mbledhë të gjitha informatat e mundshme dhe të parashtrojë padi për kompensim dëmi në emër të shfrytëzimit të paligjshëm ndaj personave që kanë pranuar pagesa të qirasë për këto dy hapësira.**

**II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për ndryshimin e vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-198/36 të datës 28 shkurt 2024 në lidhje me qiradhënien e astetit të NSh Borba – Aseti në Prishtinë, PRN206 (në likuidim) sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se në bazë të raportit të vlerësimit të datës 22.01.2024 sipërfaqja e paraqitur e lokalit nr. 1 për shkak të një gabimi teknik ishte 59 m2, ndërsa pas matjes së përsëritur del që sipërfaqja është 50 m2. Në bazë të raportit të vlerësimit të datës 14.03.2024 del që çmimi për hapësirën nr. 1 është 218 €/muaj nga sa ishte në raportin e vlerësimit të datës 22.01.2024 në shumën prej 257.00 €/muaj. Duke u bazuar në deklaratat e palëve të paraqitura edhe në kërkesë nënkuptohet që D.P.Z "Studio Meli&Nifa" është në shfrytëzim të lokalit që nga 01.03.2018 në bazë të kontratës së qirasë me një person fizik të cilit i ka paguar qira mujore.

Kështu që, Autoriteti i Likuidimit konsideroi që është e arsyeshme që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga qershori 2023 pasi që më datë 23 qershor 2023 Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka nxjerrë vendimin Nr. Ref.BD-183/26 përmes të cilit ky aset është vendosur nën administrimin e AKP-së. Andaj, nga palët do të kërkohet që para nënshkrimit të kontratës të paguajnë shumën e qirasë në mënyrë retroaktive nga qershori 2023 deri në momentin e nënshkrimit të kontratës apo të i riprogramohet brenda kontratës së qirasë.

Kështu që palës D.P.Z. "Studio Meli&Nifa" për shfrytëzimin e lokalit nr.1 në sipërfaqe prej 50 m2 në shumën prej 218.00 €/muaj do të i kërkohet të paguajë retroaktivisht shumën prej 1,962.00 € (218.00 € X 9 muaj "Qershor 2023 – shkurt 2024" = 1,962.00 EUR).
Përderisa as pala Florije Vllasaliu B.I nuk e ka nënshkruar kontratën e qirasë, atëherë edhe tek kjo palë pagesa për periudhën retroaktive do të përfshije edhe muajin shkurt 2024, dhe kësisoj për lokalin nr. 3 në sipërfaqe prej 53 m2 duhet të paguajë retroaktivisht shumën prej 2,070.00 Euro (230.00 € X 9 muaj "Qershor 2023 – shkurt 2024" = 2,070.00 EUR).

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke marrë gjithashtu për baze se qiramarrësi aktualisht është i rregullt me pagesa, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrëtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 mars 2024

X

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Nr. Ref. BD-200/25

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Neni 10, paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 mars 2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të ngastrës kadastrale P-71813001-00046-1 ZK Atmagjë, me sipërfaqe totale prej 23541m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 200,00€ në vit – aset i NSh Lavërtari Blegtori për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës – AKI.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

**ARSYETIM**

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Autoritetit të Likuidimit dhe Menaxhmentit për aprovimin e kërkesës për qira direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se me datë me datë 21.03.2024 Agjencia ka pranuar shkresën të parashtruar nga AKI, përmes së cilës kanë adresuar kërkesën për marrje me qira të kësaj hapësire me qëllim interes publik. Pasi që parashtrues i kërkesës është AKI konform nenit 10 par.3 të Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. AKI kanë deklaruar se kanë mundësi të paguajnë shumën prej 200.00 € (bruto).

Autoriteti i Likuidimit deklaron se çmimi i propozuar nga ana e AKI-së është relativisht i ulët, në krahasim me qiratë tjera në zonën përreth por bazuar në Rregulloren e lartcekur është në diskrecionin e Bordit të Drejtorëve për çmimin e propozuar nga ana e AKI-së apo të i ofrojë ndonjë çmim tjetër parashtruesit të kërkesës, duke marrë gjithmonë parasysh interesin publik të kësaj qiradhënie. Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së.

Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për NSh këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 29 mars 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-200/26

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Neni 10, paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 mars 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të hapësirës në bodrumin e objektit në pronësi të NewCo Grand Hotel , sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 50.00 bruto në muaj për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – MKRS.**

**II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Autoritetit të Likuidimit dhe Menaxhmentit për aprovimin e kërkesës për qira direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.
Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se me datë me datë 21.03.2024, AKP ka pranuar përmes e-mailit kërkesën nga MKRS ku kërkojnë që të marrin me qira hapësirën në bodrumin e objektit të NSh NeëCo Grand Hotel, duke deklaruar që kjo qiradhënie kërkohet për interes publik, ashtu që të sigurohen kushtet për përgatitjen e sportistes boksieres Donjeta Sadiku e cila do të jetë pjesëmarrëse në lojërat Olimpike Paris 2024.
Pasi që parashtrues i kërkesës është MKRS konform nenit 10 par.3 të Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. MKRS kanë deklaruar se kanë mundësi të paguajnë shumën prej 50.00 € (bruto). Autoriteti i Likuidimit deklaron se çmimi i propozuar nga ana e MKRS-së është relativisht i ulët, në krahasim me qiratë tjera në zonën përreth por bazuar në Rregulloren e lartcekur është në diskrecionin e Bordit të Drejtorëve të vendos për çmimin e propozuar nga ana e MKRS-së apo të i ofrojë ndonjë çmim tjetër parashtruesit të kërkesës, duke marrë gjithmonë parasysh interesin publik të kësaj qiradhënie.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për NSh këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 29 mars 2024.

X ______________________
Mentor Hyseni
Kryesues
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-200/27

Në bazë të neneve 9 dhe 15.2.13 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 5 dhe 16 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të ndryshuar me nenin 20 të Ligjit 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 mars 2024 nxjerr këtë:

# V E N D I M

**I. Të iniciohen procedurat e likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet të paraqitura në tabelën e mëposhtme, duke përfshirë edhe miratimin e buxhetit 2 vjeçar të likuidimit të vlerësuar për Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet një nga një, ndërsa shpenzimet e buxhetit realizohen në bazë të nenit 16 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndryshuar me nenin 20 të Ligjit 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.**

| Nr. | ID e NSh-së | Emri i NSh-së | Kategoria | Komuna | Regjioni |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PRN193 | Nacional | Aset | **Prishtinë** | **Prishtinë** |
| 2 | PRN207 | Vojvodina | Aset | **Prishtinë** | **Prishtinë** |

**II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të emëroj Autoritetet e Likuidimit (AL) për secilën Ndërmarrje Shoqërore/Aset nga pika (i) e Vendimit të Bordit (përfshirë çfarëdo zëvendësimi të kohëpaskohshëm);**

**III. Miratohet shitja e të gjitha aseteve "Sipas ligjit dhe akteve nënligjore të AKP-së", të cilat janë të listuara në dokumentet "Përmbledhje për Bord" (Board Brief) për ndërmarrjet/asetet e propozuara për fillim të procedurave të likuidimit;**

**IV. Vendimi për likuidim dhe fillimi i procedurave të likuidimit hyn në fuqi me datë 15 prill 2024**

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe aprovoi sipas procedurave inicimin e procedurave të likuidimit për dy ndërmarrjet me arsyetimet sikurse në vijim:

i. **<u>PRN193 Nacional</u>** - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, statusi i këtij aseti ka qenë i shqyrtuar nga Divizioni i Zyrës Rajonale (DZR) i AKP-së, Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Asetit dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 30 tetor 2023 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (SDR/KPS 1537U), sipas nenit 5.1 të ligjit nr. 04/L-034. Në bazë të dokumenteve që posedon DZR Prishtinë, Organizata Punues "Nacional" me seli në Beograd, Serbi, ka pasur filialë në Prishtinë, respektivisht lokalet afariste me sipërfaqe të përgjithshme prej 133.04 m2 në Adresën SU1/3A Dardani në Prishtinë. Në bazë të dokumenteve që ka mundur të siguron DZR Prishtinë, ky entitet e ka pasur vetëm asetin/et në lagjen Dardania (SU1/3A), ndërsa Organizata Punuese ka shfrytëzuar edhe një lokal tjetër në lagjen Aktash të cilin e ka marr me qira nga një person privat.

MH

ii. **PRN207 Vojvodina -** Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, statusi i këtij aseti ka qenë i shqyrtuar nga Divizioni i Zyrës Rajonale (DZR) i AKP-së, Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Asetit dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 21 dhjetor 2023 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (SDR/KPS 1535), sipas nenit 5.1 të ligjit nr.04/L-034. Në bazë të dokumenteve që posedon DZR Prishtinë "Vojvodina" - Aseti në Prishtinë, përfshinë lokalin afarist me sipërfaqe 35.88 m2 i cili gjendet në ish rr. Brigadat e Kosovës, Objekti D1, kati i parë dhe një banesë me sipërfaqe 53.73 m2 e cila gjendet në lagjen Ulpiana D-3, hyrja II, nr. 3.

Duke marrë parasysh faktet si më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 mars 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Nr. Ref. BD-200/28

Në bazë të neneve 2.7, 15.2.7 dhe 19/A të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 mars 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet kërkesa e Autoritetit të Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Ingeniering (në likuidim) PRN129 nga Rajoni i Prishtinës.**

**II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit të NSh Ingeniering (në likuidim) PRN129 nga Rajoni i Prishtinës.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të NSh Ingeniering (në likuidim) PRN129.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 mars 2024.

X/ Mentor Hyseni
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-198/29

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 42 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 shkurt 2024 nxjerr këtë:

# V E N D I M

**I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aseti nr. P-70917018-00684-5 ZK Qafështqipja - Kaçanik me sipërfaqe prej 265 m² dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.**

**II. Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

**III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga ngastra kadastrale nr. P-70917018-00684-5 ZK Qafështqipja - Kaçanik e KB "Glloboçica" GJI141 (në likuidim). Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se kjo parcelë është e evidentuar në terren shfrytëzohet për varreza të fshatit.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv për arsye se kjo parcelë shfrytëzohet si varreza, e cila i shërben interesit publik të komunitetit të caktuar.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 shkurt 2024.

X

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-200/30

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 mars 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NShBQ "Drenica" PRN011 (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 83,200.00 dhe atë për vijët buxhetore si në vijim:**

1- **e18 (Ofruesit e shërbimeve(pagesat Neto) -14,901.20 €**
2- **e19 (Tatimi i të ardhurave personale për Ofruesit e Shërbimeve) -2,285.67€**
3- **e20 (Shërbimet Profesionale) -709.40**
4- **e21 (Shërbimet për mirëmbajtjen e aseteve) -162.70 €**
5- **e27 (Mallërat) -53.00 €**
6- **e29 (Shërbimet) -11.96 €**
7- **e36 (Tatimi në pronë) -6.468.23 €**
8- **e38 (Tatimi i korporatës) -16,331.51 €**

**II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.**

**III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh PRN011 NShBQ "Drenica" PRN011.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për Ofruesit e shërbimeve(pagesat Neto), Tatimin e të ardhurave personale për Ofruesit e Shërbimeve, Shërbimet Profesionale, Shërbimet për mirëmbajtjen e aseteve, Mallërat, Shërbimet, Tatimi në pronë dhe Tatimin e korporatës - në vlerë prej €83,200.00 pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NShBQ "Drenica" PRN011. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 mars 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-200/31

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 42 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 mars 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I.** **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aseti nr. P-70403013-02684-1 me sipërfaqe prej 24949 m² ZK Gjilan dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti i NSh "IDGJ Tobacco Industry" GJI003.**

**II.** **Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

**III.** **Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga ngastra kadastrale nr. P-70403013-02684-1 me sipërfaqe prej 24949 m² ZK Gjilan pronë e NSh "IDGJ Tobacco Industry" GJI003. Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se kjo parcelë është e evidentuar në terren shfrytëzohet për varreza të qytetit.
Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv për arsye se kjo parcelë shfrytëzohet si varreza, e cila i shërben interesit publik të komunitetit të caktuar.
